

SUGJERIME TË SEKRETARIATIT MBI DRAFTET NË KONSULTIM PUBLIK

Dokumenti Politik për NVM-të 2026-2030
Strategjia Kombëtare e Industrisë 2026-2030 dhe Planit i Saj i Veprimit

KËSHILLI I INVESTIMEVE

Mbledhja XXXVIII

30 qershor 2026



DOKUMENTI POLITIK PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME 2026-2030



DOKUMENTI SI KORNIZË STRATEGJIKE



SUGJERIME TË PËRGJITHSHME



SUGJERIME SPECIFIKE




REKOMANDIMET E KI (2015-2026)

ASPEKTE POZITIVE TË KUADRIT STRATEGJIK

*Dokumenti paraqet vizionin e
Qeverisë për zhvillimin e NVM-ve
dhe përafrimin me standardet e
BE-së*

*Konfirmon fragmentimin
institucional dhe mungesën e
koordinimit si sfida kryesore
sistemike.*

*Një orientim strategjik drejt
pkonkurrueshmërisë, me structure te qarte,
njeh rolin e NVM jo vetem nga aspektet
sociale por edhe produktivitetit te
ekonomise, transformimin teknologjik*



*Prioritizon rolin thelbësor te qeverisjes dhe
se zbatimi i saj nuk varet vetëm nga masat
teknike, por edhe nga arkitektura
institucionale, koordinimi, raportimi dhe
feedback-u nga sektori privat.*

*Kornizë e integruar e disa dokumentave dhe
strategjive vertikale dhe horizontale (SZHBI,
S3, Agjenda Digjitale, NESS, politikat e
inovacionit, financimit dhe eksporteve)*

*Baze te mire llogaridhenie monitorimi i
zbatimit të masave(disa indikatore duhen
saktesuar) dhe ecurisë së tyre nëpërmjet
mekanizmave të dialogut publik-privat*

SUGJERIME TE PËRGJITHSHME



◎ METODOLOGJIA

*Një vlerësim me te thelluar të sektorit dhe madhësi të NVM-ve, apo rajoneve. **Analiza mund të mbështetet në të dhëna të krahasueshme duke adresuar mungesat aktuale të të dhënave psh rajonale dhe shmangur masat “one size fits all”. Kjo do të lehtësonte lidhjen diagnoze/objektiva/masa/buxhetim/kosto etj. Cila është logjika e kostimit.***

TË DHËNAT

*Baza analitike e dokumentit mund të plotësohet me të baze per produktivitetin, import/eksport që mund të qartësojnë me mire sfidave dhe masave që adresojnë **Produktivitetin, Tregtinë, Inovacionin, Digjitalizimin, Financimin dhe Aftësitë.** Të konsiderohet përfshirja e vlerësimit të efektivitetit të programeve ekzistuese.*

DIALOGU PUBLIK-PRIVAT

*Një rëndësinë e dialogut publik–privat dhe pranon problematikat por nuk ka analize që të tregojë se si gjetjet e këtij dialogu janë reflektuar në hartimin e masave. **Sugjerohet përfshirja e mekanizmave konkretë të konsultimit dhe argumentimi i prioritizimit të masave mbi bazën e evidencës.** P.sh: pika 2.3.3 i referohet forcimit të dialogut para miratimit të çdo mase, por nuk jepet info se si do të bëhet.*





SUGJERIME SPECIFIKE

ASPEKTE LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

OPERACIONALIZIM DHE MONITORIM MË I LEHTË

Detajim më i qartë i bazës ligjore/instrumentave ligjore që do të mundësojë zbatimin e masave të propozuara në Dokument.

TRANSPARENCË DHE VLERËSIM OBJEKTIV

Përfshirja e detyrimit për publikimin periodik të raporteve të progresit të politikave.

“THINK SMALL FIRST”

Të publikohen periodikisht rezultatet e konsultimeve të Këshillit Konsultativ të NVM-ve. Nevojat e NVM-ve të merren në konsideratë që në fazat e hershme të vendimmarrjes publike.

INDIKATORËT DHE QASJA EKONOMIKE

MONITORIM DHE VLERËSIM

Priorizohet produktiviteti dhe zgjerimi eksporteve por mungojnë indikatorë rezultatesh për matjen e produktivitetit, eksporteve dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor, përtej treguesve të output-it.

TARGETIMI I NDËRHYRJEVE

Parashikimi i masave të diferencuara që adresojnë nevojat specifike të kategorive të ndryshme të ndërmarrjeve sipas madhësisë së tyre dhe me qasje sektoriale.

KAPITALI NJERËZOR DHE AKTORËT

DISPONUESHMËRIA E KAPITALIT NJERËZOR

Adresimi i fenomenit të emigrimit të fuqisë punëtore dhe i largimit të profesionistëve të kualifikuar (“brain drain”).

SISTEMI BANKAR DHE AKSESI NË FINANCË

Arkitektura e zbatimit të përfshijë sistemin bankar si aktor kyç për aksesin në financim. Mbështetet krijimi i Observatorit të NVM-ve dhe forcimi i rolit të Bankës së Zhvillimit për monitorimin e performancës dhe arritjen e objektivave ambicioze.

SUGJERIME BAZUAR NË REKOMANDIMET E KI (2015 – 2026)

Bazuar në regjistrin e Rekomandimeve të Këshillit të Investimeve (2015 – 2026) sugjerohen për përfshirje:

43 rekomandime të KI, me status të hapur (jo të zbatuara, në proces, pjesërisht), të harmonizuara me Qëllimet Strategjike & Objektivat Specifikë të Dokumentit.

QS 1 – Sistemi i Kapaciteteve të NVM-ve

OS 1.1 Aftësitë sipërmarrëse	OS 1.2 Inovacioni & Ekonomia e dijes	OS 1.3 Digjitalizimi & Industria 4.0	OS 1.4 Standardet & Certifikimet evropiane	OS 1.5 Tranzicioni i gjelbër
Reformim i kontributeve sociale për punësimin me kohë të pjesshme (mundëson formalizimin e NVM sezonale)	Bashkëpunim Universite/Biznes: platformë online për problemet e biznesit; orientim temash diplome; ekspertizë biznesi në kurrikula	Këshillim, trajnim & rrjetëzim për NVM digjitale; ndërgjegjësim mbi ligjet nr. 62/2020 'Për Tregjet e Kapitalit' dhe ligjit nr. 66/2020 'Për Tregjet Financiare të Bazuara në Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë'. dhe Crowdfunding	Dhomat e tregtisë të krijojnë HUB-e informacioni mbi rregulloret teknike & infrastrukturën cilësore	Vlerësim diagnostikues i instrumenteve për NVM të gjelbra; udhërrëfyes “NVM e gjelbër”
Përshtatje e kurrikulave universitare; Akademi Biznesi me programe afatshkurtra në partneritet me biznesin	Politika fiskale nxitëse për ndërmarrjet me staf të dedikuar mbi Kërkim & Zhvillim	Krijimi i Programeve të dedikuara për transformimin digjital të bizneseve të vogla	Fushata MEI-MIE-AIDA-Dhomat e Tregtisë për direktivat e BE-së për standardet teknike	Ndryshim i ligjit 7/2017 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme': (a) vetëprodhuesit aktivë në tregun e parregulluar të shesin tepriat tek Operatori i Energjive të Rinovueshme; (b) rritja e kapacitetit total të vetëprodhuesve në 1 MW
Trajnime/workshope me drejtuesit (CEO) e NMVM-ve për kapitalin njerëzor; mentorim i praktikantëve	Incentiva fiskale për K&ZH: amortizim i përshpejtuar & shtesë; sponsorizimet të zbritshme	Model 3 palëshe bashkëpunimi qeveri–biznes–donatorë për investime në sektorin TIK; grante & subvencione	Skema mbështetëse për certifikime Global G.A.P., Organike, Bio për NVM agro-përpunuese	Instrument avokimi për NMVM mbi efikasitetin e energjisë & menaxhimin e mbetjeve
Strategji komunikimi MFE për mekanizmat e punësimit; bashkëpunim lokal dhomat zyrtar e punësimit /shkollat profesionale / QFP	Fushatë MEI-AIDA me bizneset & institucionet financiare për financime drejt inovacionit			Promovimi i një Çmimi vjetor “Praktikat më të Mira” për NMVM me standarde ekologjike

QS 2 – Mjedisi Operacional i NVM-ve

OS 2.1 – Cilësia rregullatore & barra administrative

Koordinim ndërinstitucional për të ulur barrën administrative; transparencë & përfshirje paraprake e biznesit në hartimin e akteve

Rishikim themelor i legjislacionit tatimor për reduktimin e burokracive dhe stabilizimin përfundimtar

Koherencë e stabilitetit fiskal dhe konsolidim i procedurave tatimore përmes një ligji të ri. Ligji i ri duhet të unifikojë të gjitha praktikatat e procedurave tatimore të parashikuara aktualisht nga disa ligje, akte nënligjore dhe rregullore. Miratimi duhet të shoqërohet me Udhëzues të detajuar që parashikon vendime të qarta tatimore.

Zgjerimi i objektivit të ligjit nr. 146/2014 'Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik', duke shtuar edhe projektaktet normative nënligjore – VKM dhe Udhëzime të Ministrave të cilat rregullojnë çështje me ndikim të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e bizneseve.

OS 2.2 – Shërbimet publike & mbështetëse për biznesin

Thjeshtim i platformës e-Albania për bizneset: filtrim/shfaqje vetëm e shërbimeve të biznesit; ndarje e ndërfaqes nga ajo e individëve

Ri-inxhinierimi i praktikave administrative dhe procedurave që lidhen me depozitimin e pasqyrave financiare duke përfutur nga funksionalitetet që ofron digjitalizimi.

Akresi i sektorit financiar në bazat e të dhënave qeveritare (ASHK, AKSHI) për përcaktimin e kolateralit

OS 2.3 – Ndërkombëtarizimi & akresi në tregje

Trajnime të targetuara për ndërkombëtarizim: sipërmarrës të rinj, eksportues, start-up, menaxherë jashtë qendrave urbane

Grante AIDA për hulumtim tregu të NMVM-ve; financim i "Kontratave të Rrjetit" konsorciume NVM për tregje të huaja

Portal Sektorial i Eksportit (AIDA): informacion tregjesh, udhëzues, rrjetëzim, statistika

Rritje e pjesëmarrjes së NMVM-ve në panairë & evente Dita e Shitjeve"; Krijimi i një baze të dhënash kombëtare e NMVM-ve eksportuese

Pranim reciprok i certifikatave fitosanitare në Ballkanin Perëndimor (CRM)

QS 3 – Ekosistemi i Kapitalit dhe Riskut në NVM

OS 3.1 – Aksesimi në financa & instrumente alternative

Kornizë e standardizuar e të dhënave për kreditimin e NVM-ve (BSH, INSTAT, banka) për produkte financiare të personalizuar

Vlerësim diagnostikues i Skemave të Garancisë Sovrane (volumi, sektorët, normat e shlyerjes, ndikimi në rritjen e biznesit)

Miratim i ligjit për “Byronë e Kredisë” me konsultim të gjerë me sektorin privat

Finalizim i kuadrit ligjor: ligj për Crowdfunding; përmirësim i ligjeve 55/2020, 62/2020, 66/2020 për tregjet financiare

Fond shtetëror/donatorësh i garantimit me ndarje risku; Fond i Përbashkët i Inovacionit Publik–Privat

Identifikim i rrjetit të “engjëjve të biznesit” & iniciativa ligjore për investimet e tyre

OS 3.2 – Edukimi & njohuritë financiare

Programe interaktive të edukimit financiar të NVM-ve, të suportuara nga teknologjia; partneritet me shoqatat e biznesit

Rishikim i roleve të punonjësve të bankave: nga ndërmjetës kredish në këshilltarë financiarë për NVM dhe startup-et

Reduktim i barrierave burokratike, thjeshtim i dokumentacionit në procedurat e huadhënies; trajtim me dinjitet i klientëve NVM

STRATEGJIA KOMBËTARE E INDUSTRIKË 2026–2030 DHE PLANIT I SAJ I VEPRIMIT



DOKUMENTI SI KORNIZË STRATEGJIKE



SUGJERIME TË PËRGJITHSHME



SUGJERIME SPECIFIKE



REKOMANDIMET E KI (2015-2026)

ASPEKTE POZITIVE TË KUADRIT STRATEGJIK

PËR HERË TË PARË PROPOZOHET NJË STRATEGJI KOMBËTARE INDUSTRIALE

Harmonizon evolucionin e politikës industriale të BE-së dhe ndryshimet gjeoekonomike globale. Adreson rikonfigurimin e zinxhirëve të furnizimit, konkurrencën teknologjike, tranzicionin e gjelbër dhe digjital dhe adopton parimet dhe prioritetet e politikës së re industriale të BE-së.

HARTIMI DHE MIRATIMI I LIGJIT PËR ZHVILLIMIN INDUSTRIAL SI MASË PRIORITARE

Masa do të plotësojë një boshllëk të rëndësishëm ligjor dhe institucional dhe rrit përafrimin me standardet evropiane, duke forcuar besueshmërinë e politikave dhe kushtet për investime afatgjata. Për efekt maksimal, rekomandohet konsultim i gjerë me sektorin privat, institucionet financiare dhe komunitetin e biznesit gjatë hartimit të ligjit.



SUGJERIME TË PËRGJITHSHME

● VIZIONI

Reflekton angazhim dhe vizion të qartë për adresimin e sfidave strukturore të ekonomisë në përputhje me prioritetet dhe standardet e BE-së.

Megjithatë, rekomandohet të përshkruhet më qartë procesi i identifikimit të sfidave prioritare, përfshirë aspektet rregullatore, institucionale dhe financiare.

● VIJUESHMËRIA

Për Objektivin Strategjik 1 (Transformimi i sistemeve të prodhimit), **rekomandohet që objektivat të bazohen në një analizë më konkrete të situatës aktuale, të mbështetur me të dhëna të matshme që mundësojnë vlerësim realist të gjendjes dhe progresit:**

- (1) Si do të mbështetet biznesi për të përballuar kostot e harmonizimit?
- (2) Si do të optimizohet inovacioni dhe në çfarë mënyre teknologjitë inovative do mund të jenë stimulues të ndryshimit në proceset e prodhimit?

● PLAN KOMUNIKIMI

Pjesë e konsultimeve të jetë edhe organizimi i diskutimeve të hapura me fokus: **(a) Politikat Industriale** dhe **(b) Konkurrueshmëria** për të siguruar mbështetje publike e transparencë mbi ndryshimet strukturore të ekonomisë shqiptare si pjesë e dinamikave integruese te vendit.



SUGJERIME SPECIFIKE 1/2

OPERACIONALIZIMI I NDËRHYRJEVE LIGJORE

Megjithëse masat janë të detajuara, rekomandohet qartësim i bazës ligjore për zbatimin e tyre, duke identifikuar aktet ligjore dhe nënligjore që kërkojnë ndryshim ose harmonizim. Gjithashtu, sugjerohen afate orientuese për reformat, për të siguruar koherencë ndërmjet objektivave strategjike dhe instrumenteve të zbatimit.

OPTIMIZIMI I REZULTATEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK-PRIVAT

Dokumenti duhet të qartësojë mekanizmat e dialogut me sektorin privat gjatë zbatimit dhe monitorimit të strategjisë, për të siguruar adresimin e nevojave reale të biznesit. Gjithashtu, rekomandohet përfshirja e një kornize të sintetizuar të inputeve nga konsultimet dhe rekomandimeve të palëve të interesuara, për të rritur transparencën dhe besimin në proces.

SUGJERIME SPECIFIKE 2/2

DINAMIKA E RITJES SË NVM-VE

Strategjia trajton NVM-të si segment kryesor të politikave industriale, por nuk fokusohet mjaftueshëm në dinamikën e rritjes së tyre. Mungon një politikë e dedikuar për zgjerimin dhe shkallëzimin e ndërmarrjeve, e cila është thelbësore për transformimin strukturor të ekonomisë.

TARGETIMI I POTENCIALIT

Strategjia ka një qasje kryesisht kombëtare dhe nuk reflekton mjaftueshëm diferencat rajonale në potencialin industrial. Rekomandohet hartimi i planeve rajonale të zhvillimit industrial për të orientuar investimet sipas avantazheve lokale, duke rritur efektivitetin e politikave dhe duke nxitur zhvillim më të balancuar territorial.

SEKTORËT PRIORITARË

Dokumenti përdor një qasje të përgjithshme ndaj industrisë, por nuk përcakton qartë sektorët prioritarë. Kjo mungesë specifikimi kufizon qartësinë strategjike dhe vështirëson vlerësimin e ndikimit si dhe orientimin e investimeve publike në sektorët me potencial më të lartë zhvillimi.

DETAJIMI I INDIKATORËVE

Dokumenti fokusohet kryesisht në indikatorë makro si vlera e shtuar, eksportet dhe inovacioni, por mungon theksimi i objektivave të produktivitetit. Sugjerohet përfshirja e treguesve si produktiviteti i punës (VAP për punonjës, prodhimi për orë pune) për një vlerësim më të saktë të efikasitetit dhe konkurrueshmërisë industriale.

SUGJERIME BAZUAR NË REKOMANDIMET E KI (2015 – 2026)

Bazuar në regjistrin e Rekomandimeve të Këshillit të Investimeve (2015 – 2026) sugjerohen për përfshirje:

35 rekomandime të KI, me status të hapur (jo të zbatuara, në proces, pjesërisht), të harmonizuara me Qëllimet Strategjike & Objektivat Specifikë të Dokumentit

QS 1 – Transformimi i sistemeve të prodhimit

OS 1.2 – Burimet, dekarbonizimi & praktikat qarkulluese

Subvencionim i specialistëve të K&ZH në ekonomi qarkulluese & energji të rinovueshme; fokus AI/digjitalizim për produktivitetin e sektorëve me intensitet të lartë energjie

Vlerësim i instrumenteve në dispozicion të NVM-ve, veçanërisht për ato që operojnë në sektorë kryesorë (turizëm, ndërtim) për t'i suportuar mbi pasiguritë lidhur me burimet e financimit, kthimin e investimeve në burime të rinovueshme, sigurinë e energjisë dhe legjislacionin në fuqi; si dhe krijimi i një liste me ndërhyrje prioritare që fokusohen në udhërrëfyesit për NVM-të e gjelbra.

Ndryshim i ligjit nr. 7/2017 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme', duke (a) i dhënë mundësinë vetëprodhuesve aktivë në tregun e parregulluar të shesin tepricat tek Operatori i Energjive të Rinovueshme; (b) duke rritur kapacitetin total të vetëprodhuesve në 1 MW.

Instrument i posaçëm avokimi për NMVM mbi efikasitetin e energjisë & menaxhimin e mbetjeve (prodhim & turizëm), i lidhur me asistencën teknike të BE-së

OS 1.3 – Digjitalizimi i sistemeve të prodhimit industrial

Kornizë rregullatore për ekonominë digjitale & platformat online; qartësim i kuadrit për tregtinë elektronike dhe pagesat elektronike

Thjeshtim i ekosistemit digjital të vendit; finalizim i kuadrit për nënshkrimin digjital për të lehtësuar transaksionet e biznesit

QS 2 – Integrimi në ekosistemet evropiane dhe rritja cilësore e eksporteve

OS 2.1 Lidhjet me prodhimin evropian	OS 2.2 Standardet & infrastruktura e cilësisë	OS 2.3 Barrierat ndërkufitare & doganat	OS 2.4 Eksporti cilësor & diversifikimi
MEI të krijojë një bazë të dhënash të prodhuesve vendas sipas produkteve; analiza për identifikimin e sektorëve me potencial konkurrues & eksporti. Përditësim vjetor	Përshpejtim i transpozimit të Rregullores së Produkteve të Ndërtimit (CPR); Shqipëria i vetmi vend i CEFTA-s pa transpozim	DPD: publikim periodik i çmimeve të referencës dhe rasteve tipike; heqje e çmimeve të referencës për transportin me kontejnerë	AIDA: Përditësimi i Portalit Sektorial të Eksportit me informacion tregjesh, udhëzues, rrjetëzim ndërkombëtar, këshillim, statistika
Financim i “Kontratave të Rrjetit për Ndërkombëtarizimin” për klasterizim industrial me ofertë të përbashkët në treg të huaj	Forcim i mbikëqyrjes së tregut/inspektorateve: model risku, trajnime sipas performancës, procedurë denoncimi, njoftime anonime	Pranim reciprok i certifikatave fitosanitare në Ballkanin Perëndimor; heqje e barrierave jo-tarifore (CRM)	AIDA: rritje e pjesëmarrjes së NMVM-ve në misione tregtare, panaire, evente “Dita e Shitjeve” për prodhim & agro-përpunim; evente B2B
Incentiva për bashkëpunim fermerësh: thjeshtim procedural; lehtësi për regjistrim toke & leje ndërtimi; incentiva fiskale për kooperativa	Dhomat e Tregtisë të krijojnë HUB informacioni mbi rregulloret teknike & infrastrukturën cilësore për sektorët prioritarë		
	Skema mbështetëse për certifikime: Global G.A.P., Organike, Bio për agro-përpunim; kontroll i inputeve bujqësore		

QS 3 – Ekosisteme dinamike të inovacionit industrial

OS 3.2 – Transferimi i teknologjisë & bashkëpunimi industri–kërkim

Strukturim formal i bashkëpunimit Universitet–Biznes: platformë online për problemet e biznesit; orientim temash diplome; ekspertizë biznesi në kurrikula

Fushatë e koordinuar MEI-AIDA me bizneset & institucionet financiare për financime drejt inovacionit; ndërgjegjësim i NVM-ve mbi K&ZH

Përshtatje e kurrikulave universitare me nevojat e industrisë; programe afatshkurtra inovative në partneritet me biznesin (Akademi Biznesi)

OS 3.3 – Sektori privat në K&ZH dhe inovacionin industrial

Incentiva fiskale për K&ZH: njohja si shpenzime të zbritshme të sponsorizimeve për K&ZH

Politika fiskale nxitëse për ndërmarrjet me buxhet dhe staf të dedikuar për K&ZH

Identifikim i rrjetit të “engjëjve të biznesit” & iniciativa ligjore për investimet e tyre

Fond i Përbashkët i Inovacionit Publik–Privat; fond shtetëror/donatorësh i garantimit me ndarje risku; platformë kombëtare e unifikuar

Heqje tatimi për fitimet e ri-investuara; shtrirje e periudhës së mbartjes së humbjeve tatimore si stimuj për investime industriale

QS 4 – Arkitekturë koherente e zhvillimit industrial

OS 4.1 Financimi industrial & zbutja e riskut	OS 4.2 Absorbimi i fondeve të BE-së & ndërkombëtare	OS 4.3 Fuqia punëtore me prioritetet industriale	OS 4.4 Qeverisja & monitorimi industrial
Vlerësim diagnostikues i Skemave të Garancisë Sovrane (volumi, sektorët, normat e shlyerjes, ndikimi në biznes)	Ngritje kapacitetesh biznesi për aplikim në fonde të BE-së (COSME, WBIF, IPA III); projekte sektoriale për thithje më të lartë fondesh	Strategji komunikimi MEI për punësimin: bashkëpunim lokal dhomat/zyrat e punësimit/shkollat profesionale/QFP/pushtet lokal/donatorë	Mekanizëm transparent i monitorimit të bashkërendimit të Investimeve Publike (qendrore & vendore) me strategjitë e sektorëve prioritarë
Miratim i ligjit për “Byronë e Kredisë” me konsultim të gjerë publik me sektorin privat	Komponent i ri në aida-smefinance.gov.al: bazë e dhënash e NMVM-ve përfituese të granteve me vlerësim, pikëzim, indikatorë besueshmërie	Forcim i bashkëpunimit dhomat e tregtisë + QFP për rikualifikim & upskilling në teknologji, automatizim, aftësi digjitale	
Finalizim i kuadrit ligjor: ligj për Crowdfunding; përmirësim i ligjeve 55/2020, 62/2020, 66/2020 për tregjet financiare		Reformim i sistemit të kontributeve sociale për punësimin me kohë të pjesshme – mundëson formalizimin në sektorë me sezonalitet	
Fond shtetëror/donatorësh i garantimit me ndarje risku; Fond i Përbashkët Publik – Privat; platformë kombëtare e unifikuar			

FALEMINDERIT!

www.investment.com.al